



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:231189
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728820

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarit L.... Z.... për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr. 1684/23 të datës 27.10.2023, pas mbajtës së seancës se shqyrtimit fillestar të hapur për publikun me datë në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit L.... Z..., me datë mori dhe shpalli publikisht ndërsa me datë përpiloi këtë:

A K G J Y K I M

I pandehuri,

L.... Z....j, i biri i dhe nënës G.... e vajzërisë D....., i lindur me në P....., ku edhe banon ne rr. “ P.... G.... ,nr... P..., i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor ne firmën D... C..., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, posedon nr. të telefonit, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar në parë, **mbrohet në liri.**

ËSHTË FAJTORË

Për shkak se:

Me dt., rreth orës ...:.. në rr. “N.... V...” nr. .. në P...., pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope ose analoge me sasi prej 1.0 gram, në atë mënyrë që gjersa zyrtaret policor kishin informacion se i pandehuri L.... është dyshuar për një rast vjedhje kishin shkuar në adresën e lartcekur në një shtëpi të pabanuar ku ishte duke qëndruar i pandehuri dhe gjatë kontrolles në gjepin e pantallonave i gjejnë dhe i konfiskojnë një letër me substancë narkotike, ashtu që pas kryerjes së analizës së narkotikut ka rezultuar substanca e llojit Marihuanë me peshë neto prej 1.0 gram,

-me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7, 17, 21, 38, 39, 42, 43, 69, 70, 71, 72, 248 par. 1 të KPRK-së, nenit 6, 7 dhe 365 të KPPRK-së, të pandehurit L.... Z....j i shqipton:

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej **9 (nëntë) muajve**, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300,00 € (treqind euro), të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 40 € (dyzet) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan, në peshë prej 1.0 gram.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 27.10.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 1684/23 ndaj të akuzuarit L.... Z... për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-së e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzat dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Më pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë. I pandehuri është deklaruar se: e pranoj fajësinë për vepër penale sipas aktakuzës, sa i përket kësaj vepre penale është hera e parë që e kam kryer , kërkoj falje.

Në vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurores së Shtetit e cila ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te

pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet ne këto prova: Raporti i oficerit E...H... KPS-11087 i dt. 23.08.2023; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i DHTN në Pejë i dt.23.08.2023; Raportit i analizës se narkotikeve i DHTN-së i dt. 20.09.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje i të dyshuarit L.... Z....j e dhënë në stacion policor në Pejë me dt. 19.08.2023; Foto dokumentacioni i shkresave të lëndës, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë. Faktin se i njëjti është recidivistë i veprave penale nga se më parë është dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelor në P... P.nr.../.. i datës , për shkak të veprës penale “Vjedhje” e mbetur në tentativë nga neni 313 par.1 të KPRK-së, i dënuar me dënim burgu me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, po ashtu ndaj të njëjtit janë në zhvillim e sipër procedura penale sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II nr. 2601/23 e datës 18.01.2024 për dy vepra penale të “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 KPRK-së, PP/II nr.1908/23 e datës 03.11.2023 për veprat penale kanosja” nga neni 181 par. 1 të KPRK-së dhe posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, PP/II nr. 2226/2023 e datës 05.12.2023 për tri vepra penale të vjedhjes nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, PP / II Nr.129/2023 e datës 15.03.2023 për veprën penale “Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPK-së duke marr parasysh se dënimi i e mëparshme me kusht dhe me gjobë nuk ka ndikuar ne rehabilitimin e tij

andaj parandalimi nga kryerja e veprave penale në të ardhmen do të funksionoj vetëm me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale për paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € dhe për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 20,00 €.

Konform nenit 269 par. 3 të KPRK-së gjykata të akuzuarit i ka konfiskuar substancën narkotike e llojit marihuan, në peshë prej 1.0 gram.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2023:231189, 23.05.2024**

Bashkëpunëtorja profesionale

Gjyqtari i vetëm gjykues

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.